

Njoftim privatësie për Sova Assessment Limited (Kandidatët)

Ky njoftim privatësie vihet në disponim në dobi të të gjithë kandidatëve dhe individëve që ngarkojnë të dhëna personale dhe të tjera informacione personale në mjetin testues në internet dhe në shërbime përkatëse që sigurohen nga Sova Assessment Limited (**Mjetet Sova Assessment**). Mjetet Sova Assessment sigurohen në emër të një punëdhënësi, punëdhënësi të mundshëm ose organizate tjetër kliente që ka vendosur të përdorë Mjetet Sova Assessment (**Organizata Kliente**) si pjesë e një fushate të caktuar rekrutimi ose projekti të ngjashëm.

Për qëllimet e këtij njoftimi privatësie, një kandidat ose individ i referohet çfarëdo personi që ose po kërkon punësim me Organizatën Kliente, ose është në proces të një fushate rekrutimi ose zhvillimi, ose procesi të ngjashëm.

"Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave" përfshin "Rregulloren e përgjithshme e MB-së për mbrojtjen e të dhënave" (UK GDPR), "Ligjin për mbrojtjen e të dhënave 2018" (DPA 2018), "Rregulloret për privatësi dhe komunikime elektronike" (Direktivë e Komisionit Evropian) 2003 (PECR) dhe të gjitha legjislacionet e tjera të zbatueshme në fuqi herë pas here në MB për mbrojtjen e të dhënave bashkë me (ku Organizata Kliente është në BE) "Rregulloren e përgjithshme të BE-së për mbrojtjen e të dhënave" (EU GDPR) 2016/679) dhe të gjitha legjislacionet e tjera të BE-së që janë në fuqi herë pas here për mbrojtjen e të dhënave.

GDPR-ja e MB-së është tepër e ngjashme me GDPR-në e BE-së. Në këtë procedurë, referimi ndaj "GDPR"-së si një e vetme do të thotë edhe "GDPR e MB-së", edhe "GDPR e BE-së".

1. HYRJE

Sova Assessment i përkushtohet veprimeve në përputhje me legjislacionin aktual për mbrojtje të dhënash dhe, si rrjedhojë, në mbrojtjen e privatësisë suaj. Ky njoftim privatësie përcakton se si i përpunojmë të dhënat, dhe përfshin:

- statusin tonë, për qëllimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave.
- qëllimin dhe kë mbulon njoftimi për sa i përket të dhënave personale.
- kush jemi dhe kë të kontaktoni.

- të dhënat personale që mbledhim dhe mbajmë rreth jush.
- si i mbledhim këto të dhëna.
- si i depozitojmë dhe përdorim të dhënat personale.
- bazat tona ligjore për përpunimin e të dhënave personale.
- informacion mbi transfertat te palë të treta dhe transferta ndërkombëtare.
- të drejtat tuaja si subjekt të dhënash.

2. NE VEPROJMË SI PËRPUNUES TË DHËNASH NË EMËR TË ORGANIZATËS KLIENTE

Për qëllimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave, Sova Assessment vepron si përpunuese të dhënash në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të kandidatit. Kjo do të thotë se Sova ju përpunon të dhënat sipas udhëzimeve të Organizatës Kliente (pra, punëdhënësit ose punëdhënësit të mundshëm me të cilin jeni lidhur) që ka autorizuar përdorimin e Mjeteve Sova Assessment.

Organizata Kliente është kontrolllore e të dhënave për qëllimet e legjislacionit për mbrojtje të dhënash. Informacion i mëtejshëm për sa i përket mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave tuaja nga Organizata Kliente do të përmbahet në njoftimin e privatësisë nga Organizata Kliente.

3. QËLLIMI

Ky njoftim privatësie jepet në dobi të të gjithë kandidatëve të cilëve u mbledhen të dhënat personale me anë të vetë-futjes në Mjetet Sova Assessment, ku jepen komente vlerësuese pas plotësimit të një testi në internet, dhe/ose pas pjesëmarrjes në çfarëdolloj procesi rekrutimi apo zhvillimi, ose projekti të ngjashëm. Qëllimi mbulon edhe të gjithë kandidatët të dhënat personale të të cilëve mbledhen përmes Organizatës Kliente (punëdhënësit ose punëdhënësit të mundshëm me të cilin jeni lidhur) dhe na jepen neve, sipas kërkesave të legjislacionit për mbrojtje të dhënash.

4. KUSH JEMI NE DHE KË TË KONTAKTONI

4.1 Kush jemi ne

Ne jemi Sova Assessment Limited, një kompani e regjistruar në Angli me seli të regjistruar në Sterling House, 19/23 High Street, Kidlington, Oxfordshire, England, OX5 2DH. Selia evropiane e Sova Assessment ndodhet në Suite 2241, 26 Upper

Pembroke Street, Dublin 2. Ne jemi specialistë testimesh në internet dhe kemi synim t'u vijmë në ndihmë punëdhënësve që të marrin vendime të sakta dhe të mirëinformuara; dhe të sigurojmë që testet të përcjellin përvojën më të mirë që është e mundur për kandidatët.

Ne ofrojmë zgjidhje për testim dixhital, shërbime konsultimi për menaxhim talenti krahas një sere zgjidhjesh për trajnim të personalizuar.

4.2 Përgjegjësitë

Te Sova Assessment kemi një menaxher për mbrojtjen e të dhënave që është përgjegjës brenda biznesit për të siguruar që ky njoftim t'u disponohet kandidatëve para se Sova Assessment t'ua mbledhë/përpunojë të dhënat personale.

Menaxheri ynë për mbrojtjen e të dhënave mund të kontaktohet drejtpërdrejt këtu (megjithëse do të rekomandonim që të kontaktoni Organizatën Kliente - si kontrollore e të dhënave - në mundësinë më të parë, nëse keni pyetje në lidhje me të dhënat tuaja personale):

- compliance@sovaassessment.com
- 0207 947 4330

Sova Assessment ka lidhur kontratë me shërbimet e kompanisë GRCI Law, e cila vepron si funksionar i mbrojtjes së të dhënave për të (Data Protection Officer - DPO). Prandaj, Sova Assessment do të kërkojë këshilla, udhëzim, dhe njohuri nga DPO-ja ku të jetë nevoja.

5. Ç'TË DHËNA PERSONALE PËRPUNOJMË

Të dhënat personale që përpunojmë në emër të klientit të Sova-s kur përdorni Mjetet Sova Assessment renditen më poshtë:

Lloji i të dhënave personale:	Burimi:
Emri dhe adresa e postës elektronike	Ju - kur plotësoni një test në internet, ku jepen komente vlerësuese pas plotësimit të testit në internet dhe/ose kur merrni pjesë në çfarëdolloj procesi rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm. Mund të mblidhen të dhëna edhe nga

	Organizata Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur)
Emër përdoruesi ose identifikues i ngjashëm	Gjeneruar automatikisht nga platforma jonë vlerësuese në internet
Numër kontakti	Ju - kur plotësoni një test në internet, ku ju jepen komente vlerësuese. Mund të mblidhen të dhëna edhe nga Organizata Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur)
Mosha	Ju - kur plotësoni një test në internet, ku jepen komente vlerësuese pas plotësimit të testit në internet dhe/ose kur merrni pjesë në çfarëdolloj procesi rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm. Mund të mblidhen të dhëna edhe nga Organizata Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur)
Fotografia juaj	Kjo mund t'ju kërkohet nga Organizata Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur) kur merrni pjesë në çfarëdolloj procesi rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm.
Një video-intervistë	Mund t'ju shtrohet kërkesa të merrni pjesë në një video-intervistë si pjesë e procesit të rekrutimit dhe/ose zhvillimit, ose një projekti të ngjashëm.

Informacioni i mbledhur dhe futur në CV.	Kjo mund t'ju kërkohet nga Organizata Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur) kur merrni pjesë në çfarëdolloj procesi rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm.
Informacion mbi ndonjë aftësi të kufizuar që mund të keni	Ju - kur plotësoni një test në internet, dhe/ose kur merrni pjesë në çfarëdolloj procesi rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm. Mund të mblidhen të dhëna edhe direkt nga Organizata Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur)
Detaje nga historiku juaj i arsimit dhe punësimit	Ju - ku merrni pjesë në çfarëdolloj procesi rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm. Mund të mblidhen të dhëna edhe nga Organizata Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur)
Adresa IP	Ju - ku merrni pjesë në çfarëdolloj procesi rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm.

6. PËRPUNIMI QË U BËJMË TË DHËNAVE TUAJA

Të dhënat tuaja personale i përpunojmë në emër të Organizatës Kliente që ka autorizuar përdorimin e Mjeteve Sova Assessment (dhe shërbimeve përkatëse) për qëllimet në vijim:

Lloji i të dhënave personale:	Qëllimi:
Emri, adresa e postës elektronike, numri i telefonit dhe emri i përdoruesit ose	Për t'ju administruar juve një ftesë të gjeneruar me kompjuter që ju mundëson ta plotësoni testin në

identifikues i ngjashëm	<p>internet.</p> <p>Për t'ju dhënë juve dhe Organizatës Kliente (punëdhënësit/punëdhënësit të mundshëm me të cilin jeni lidhur) një raport vlerësimi që paraqet rezultatet e testit tuaj.</p> <p>Aty ku jepen komente vlerësuese pas përfundimit të testit në internet, që seance e komenteve të kryhet me ne.</p> <p>Në raste kur merrni pjesë në çfarëdo procesi rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm, për të ndihmuar punëdhënësin të marrë vendime të sakta dhe të mirë-informuara si pjesë e këtij procesi.</p>
Moshë	<p>Këtë e përdorim vetëm për qëllime kërkimi dhe zhvillimi, në formë të anonimizuar, për të prodhuar norma psikometrike dhe të dhëna vlefshmërie dhe/ose për të ndihmuar me prodhimin e manualeve tona psikometrike</p>
Fotografia juaj	<p>Për të ndihmuar Organizatën Kliente (punëdhënësin/punëdhënësin e mundshëm me të cilin jeni lidhur) t'ju identifikojë kur merrni pjesë në çfarëdo procesi rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm.</p>
Një video-intervistë	<p>Për t'u përdorur si pjesë a procesit të rekrutimit dhe/ose zhvillimit, ose një projekti të ngjashëm, për të ndihmuar Organizatën Kliente (punëdhënësin/punëdhënësin e mundshëm me të cilin jeni lidhur) të marrë vendime të sakta dhe të mirë-</p>

	informuara.
Informacioni i mbledhur dhe futur në një CV.	Për t'u përdorur si pjesë a procesit të rekrutimit dhe/ose zhvillimit, ose një projekti të ngjashëm, për të ndihmuar Organizatën Kliente (punëdhënësin/punëdhënësin e mundshëm me të cilin jeni lidhur) të marrë vendime të sakta dhe të mirë-informuara.
Informacion mbi ndonjë aftësi të kufizuar që mund të keni	Në raste kur duhet të bëhen përshtatje të arsyeshme për ju për t'ju mundësuar të kryeni testin vlerësues në internet dhe/ose të merrni pjesë në çfarëdo prej procesit rekrutimi ose zhvillimi, ose projekti të ngjashëm.
Detaje nga historiku juaj i arsimit dhe punësimit	Këtë e përdorim vetëm për qëllime kërkimi dhe zhvillimi, në formë të anonimizuar, për të prodhuar norma psikometrike dhe të dhëna vlefshmërie dhe/ose për të ndihmuar me prodhimin e manualeve tona psikometrike
Adresa IP	Për funksionimin e platformës sonë

7. BAZA JONË LIGJORE E PËRPUNIMIT

Ne jua përpunojmë të dhënat personale vetëm në përputhje me udhëzimet e përfshira në kontratë me Organizatën Kliente. Baza jonë ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja rrjedh nga baza ligjore e Organizatës Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur), dhe përfshin:

Interesa legjitime

- për të ofruar testet tona psikometrike në internet dhe çfarëdo nga produktet dhe shërbimet e tjera që kemi.

- për të ndihmuar t'i mundësojë Organizatës Kliente (punëdhënësit/punëdhënësit të mundshëm me të cilin jeni lidhur) të marrë vendime të sakta dhe të mirë-informuara për qëllimet e veta të rekrutimit dhe/ose zhvillimit.
- për t'ju dhënë komente vlerësuese mbi rezultatet e testeve, juve si individ.
- për t'i mbajtur arkivat tona të përditësuara.
- për të kryer kërkime dhe zhvillime për përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve tona.

Mbarëvajtja e një kontrate

- për të mundësuar mbarëvajtjen e kontratës (si p.sh. të një kontrate ekzistuese punësimi) ose për të ndërmarrë hapa para lidhjes së një kontrate (si p.sh. të një kontrate të re të mundshme punësimi për një të rekrutuar të mundshëm të ri).

Dhënia e miratimit:

- në lidhje me përpunimin e të dhënave në kategori të veçanta (që i përpunojmë kur Organizata Kliente na e kërkon këtë gjë).

Lloji i të dhënave personale:	Baza ligjore për përpunimin:
Emri dhe adresa e postës elektronike	Interesa legjitime Mbarëvajtja e një kontrate
Emër përdoruesi ose identifikues i ngjashëm	Interesa legjitime
Numër kontakti	Interesa legjitime
Mosha	Interesa legjitime
Fotografia juaj	Interesa legjitime
Një video-intervistë	Interesa legjitime

Informacioni i mbledhur dhe futur në CV.	Interesa legjitime
Informacion mbi ndonjë aftësi të kufizuar që mund të keni	Interesa legjitime
Detaje nga historiku juaj i arsimit dhe punësimit	Interesa legjitime
Adresa IP	Interesa legjitime

8. KATEGORI TË VEÇANTA TË DHËNASH

Ne përpunojmë të dhëna nga ju në kategori të veçanta në emër të Organizatës Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur) vetëm kur keni dhënë miratim. Të dhëna të tilla në kategori të veçanta janë vetëm ato që janë dhënë nga ju, subjekti i të dhënave, dhe përpunohen nga me vetëm në rastet kur keni dhënë miratim duke u pajtuar me përdorimin e Mjeteve Sova Assessment për qëllim fushate rekrutimi ose projekti nga Organizata Kliente.

Kategoritë e veçanta të të dhënave personale për të cilat bëhet fjalë janë:

Lloji i të dhënave personale:	Baza ligjore për përpunimin:
Kombësia	Interesa legjitime
Gjinia	Dhënia e miratimit
Etnia	
Raca	
Plus, çfarëdo kategorish të veçanta shtesë të dhënash që mund të kërkohen nga Organizata Kliente (punëdhënësi me të cilin jeni lidhur)	

9. DHËNIA E MIRATIMIT

Kërkohet miratim që Sova Assessment të përpunojë të dhënat në kategori speciale sikurse u referohet më sipër. Një miratim i tillë merret nga Organizata Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur) në pikën kur bini dakord të përdorni Mjetin Sova Assessment para se të futni ndonjë informacion në një mjet të tillë.

Mund ta tërhiqni miratimin për përpunimin që u bëjnë të dhënave në kategori të veçanta në çfarëdo kohe duke kontaktuar Organizatën Kliente (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur) për ta vënë në dijeni që e keni tërhequr miratimin. Procesi me anë të të cilit duhet të kontaktoni Organizatën Kliente gjendet në njoftimin e privatësisë nga Organizata Kliente.

10. SHPËRFAQJE

Sova Assessment mund t'i ndajë të dhënat tuaja me palë të treta për qëllimet e parashtruara më poshtë:

Filialet e Sova Assessment

- cilado nga filialet tona për qëllime kërkimi dhe zhvillimi, për shembull, për të prodhuar norma psikometrike dhe të dhëna vlefshmërie dhe/ose për të ndihmuar me prodhimin e manualeve tona psikometrike Në lidhje me këtë, të dhënat ndahen vetëm në mënyrë anonime ose të grumbulluar.

Palë të treta (që veprojnë si nën-përpunuese)

- filiale që ofrojnë shërbime në emrin tonë për të na mundësuar përcjelljen e Mjeteve Sova Assessment (dhe shërbimeve përkatëse).
- furnitorë që na ofrojnë informatikë, administrim sistemi dhe shërbime platformash, si dhe furnitorë që ofrojnë çfarëdo shërbimesh të tjera të lidhura me shërbimet që ofrojmë.

Siç kërkohet nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave, çdo ndarje e të dhënave personale i nënshtrohet detyrimeve të duhura të konfidencialitetit dhe masave mbrojtëse, sipas këtyre më poshtë.

- klauzolat kontraktuale përkatëse janë në operim për të siguruar ekzaminimin e gjithanshëm (*due diligence*) për palë të treta në lidhje me sigurinë e të dhënave.

- proceset e palëve të treta kontrollohen për të siguruar zbatimin e masave të përshtatshme siguruese.

11. TRANSFERIME NDËRKOMBËTARE TË DHËNASH

Në raste kur të dhënat personale transferohen jashtë MB-së dhe ZEE-së (që përfshin të gjitha shtetet e BE-së plus Islandën, Liçtenshtajnin dhe Norvegjinë), ne ndërmarrim të gjitha masat e nevojshme brenda arsyes për të siguruar që mbrojtja e ofruar nga GDPR-ja do të udhëtojë bashkë me të dhënat dhe që të dhënat t'ju trajtohen me siguri dhe në përputhje me këtë njoftim privatësie dhe me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave. Kjo do të thotë se kur transportojmë të dhëna jashtë shtetit, do të sigurohemi që t'i përmbahemi njëres nga masat në vijim:

- mbrojtjet jo nga MB-ja/jo nga BE-ja konsiderohen të mjaftueshme nga BE-ja.
- klauzolat kontraktuale përkatëse janë në operim për të siguruar ekzaminimin e gjithanshëm (*due diligence*) për palë të treta në lidhje me sigurinë e të dhënave.
- proceset e palëve të treta kontrollohen për të siguruar zbatimin e masave të përshtatshme siguruese.
- janë të zbatueshme baza specifike për transferimin (derogime) siç janë dhënia e miratimit nga individit.

12. PERIUDHA E MBAJTJES

Sova Assessment do të përpunojë të dhëna personale për sa kohë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimit për të cilat të dhënat janë mbledhur, sikurse është rënë dakord me Organizatën Kliente (punëdhënësin/punëdhënësin e mundshëm me të cilin jeni lidhur). Për informacion të mëtejshëm, ju lutemi referojuni njoftimit të privatësisë nga Organizata Kliente.

Përveç kur Sova udhëzohet ndryshe nga Organizata Kliente, të gjitha të dhënat personale të kandidatëve të mbledhura në sistemet e Sova-s do të anonimizohen për qëllimet e Sova-s 6 muaj pas dorëzimit dhe "çelësi dixhital" për çanonimizimin e të dhënave personale do t'i jepet Organizatës Kliente. Çelësi dixhital atëherë do të fshihet përgjithmonë nga sistemet e Sova-s.

Pas anonimizimit, të dhënat mund të vazhdojnë të përdoren nga Sova për zhvillimin e normave të reja dhe zhvillimin e softuerëve dhe shërbimeve të Sova-s. Të dhënat e anonimizuara mund të vazhdojnë të përdoren pa kufi kohor nga Sova.

Nëse ju duhet informacion i mëtejshëm mbi periudha specifike të mbajtjes, ju lutemi nga kontaktoni (shikoni pjesën 4.2 sesi të na kontaktoni)

13. VENDIM-MARRJE E AUTOMATIZUAR

Vendim-marrje e autorizuar do të thotë marrje vendimesh në lidhje me mospërdorimin nga ju të përfshirjes njerëzore. Produktet dhe shërbimet që Sova Assessment ju ofron, në emër të klientëve tanë (punëdhënësi/punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur) zakonisht nuk përdoren veç e veç në proceset e rekrutimit ose të zhvillimit, por përdoren më fort për të ndihmuar punëdhënësit të marrin vendime të sakta dhe të mirë-informuara.

Në raste kur Organizata Kliente (punëdhënësi/ punëdhënësi i mundshëm me të cilin jeni lidhur) përdor Mjetet Sova Assessment në mënyrë të tillë që një vendim merret në lidhje me ju vetëm në bazë të ndërveprimit që keni me Mjetet Sova Assessment, ky përdorim do të bëhet ose në bazë të faktit që kjo është e nevojshme për të lidhur kontratë, ose për rendimentin e saj, mes Organizatës Kliente dhe jush, ose në bazë të miratimit tuaj të shprehur hapur. Në raste të tilla, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave keni një sërë të drejtash në lidhje me të tilla përpunime, përfshirë të drejtën për të kundërshtuar dhe të drejtën për të marrë ndërhyrje njerëzore nga ana e Organizatës Kliente, për të shprehur këndvështrimin tuaj dhe ankimuar vendimin. Ju lutemi kontaktoni Organizatën Kliente (punëdhënësin/punëdhënësin e mundshëm me të cilin jeni lidhur) nëse keni ndonjë pyetje mbi përdorimin e vendim-marrjes të automatizuar në këtë situatë.

14. SI JUA MBAJME TË DHËNAT TË SIGURUARA

Sova Assessment angazhohet për të mundësuar sigurimin e të dhënave tuaja. Si përpunues të dhënash, ne sigurohemi që të merren të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur ndaj humbjeve të mundshme, zbulimit të paautorizuar ose hyrjes në të dhëna personale që përpunojmë ose përdorim. Sova Assessment zbaton masat mbrojtëse në vijim për të mundësuar sigurimin e të dhënave tuaja.

- të dhënat e kandidatëve do të anonimizohen 6 muaj pasi të jenë dorëzuar në sistemet e Sova-s, përveçse kur udhëzohet ndryshe nga Organizata Kliente me të cilën jeni lidhur (ju lutemi shikoni pjesën 12 më lart).

- qasja në të dhënat personale ndalohet për individë të paautorizuar.
- në operim ka rregullore të siguruara enkriptimi.
- të gjitha dispozitat e certifikimit ISO 27001.

15. TË DREJTAT TUAJA SI SUBJEKT TË DHËNASH

Në çfarëdo faze kur kemi në dorë ose po përpunojmë të dhënat tuaja, ju, subjekti i të dhënave, keni të drejtat në vijim:

- Të drejtën e qasjes – keni të drejtë të kërkonti një kopje me informacionin që mbajmë rreth jush.
- E drejta e ndreqjes – keni të drejtë të korrigjoni të dhënat që mbajmë rreth jush që janë të pasakta ose të paplota.
- E drejta për t'u harruar – në rrethana të caktuara, mund të kërkonti që të dhënat që mbajmë rreth jush të fshihen nga arkivat tona.
- E drejta për kufizim përpunimi – në raste që vlejnë për kushte të caktuara për të pasur të drejtën e kufizimit të përpunimit.
- E drejta e transportueshmërisë – keni të drejtën të kërkonti transferimin e të dhënave që mbajmë rreth jush te një organizatë tjetër në situata të caktuara.
- E drejta për të kundërshtuar – keni të drejtën të kundërshtoni disa lloje të caktuara përpunimi siç është marketimi i drejtpërdrejtë.
- Të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e automatizuar, përfshirë profilizimin.
- E drejta për rishikim gjyqësor: në rastin kur jua refuzojmë kërkesën sipas të drejtave të qasjes, do t'ju japim arsyen pse. Keni të drejtën të paraqitni ankesë sikurse ravijëzohet në klauzolën 17 më poshtë.

Mund të ushtroni të drejtën duke na kontaktuar në adresën e postës elektronike në vijim – compliance@sovaassessment.com

Të gjitha kërkesat e mësipërme do t'i përcillen Organizatës Kliente, që vepron si kontrollor i të dhënave ose, po qe se ka një palë të tretë të përfshirë (sikurse

shprehet te 10 më lart) në përpunimin e të dhënave tuaja personale, do t'i përcillen edhe palëve përkatëse.

16. NDRYSHIME

Mund ta përditësojmë dhe ta ndryshojmë këtë njoftim privatësie herë pas here. Nëse ka përditësime, do të afishohen në uebsitin tonë.

17. ANKESA

Në rast se dëshironi të paraqisni një ankesë për mënyrën si po ju përpunohen të dhënat nga Sova Assessment (ose palët e treta siç përshkruhet te 10 më lart), ose si ju është trajtuar ankesa, keni të drejtën të depozitoni ankesë drejtpërdrejt te autoriteti mbikëqyrës dhe te përfaqësuesit e Sova Assessment për mbrojtje të dhënash.

Sova Assessment ka lidhur kontratë me shërbimet e kompanisë GRCI Law, e cila vepron si funksionar i mbrojtjes së të dhënave për të (Data Protection Officer - DPO). Prandaj, Sova Assessment do të kërkojë këshilla, udhëzim, dhe njohuri nga DPO-ja ku të jetë nevoja.

Detajet për secilin prej këtyre kontakteve janë:

Emri i kontaktit	Autoriteti mbikëqyrës	Funksionari për mbrojtjen e të dhënave
Rreshti 1 i adresës:	UK Information Commissioner's Office (ICO)	GRCI Law
Rreshti 2 i adresës:	Wycliffe House, Water Lane	GRC International Group Plc Unit 3 Pride Court
Rreshti 3 i adresës:	Wilmslow	Bartholomew's Walk Cambridgeshire Business Park
Rreshti 4 i adresës:	Cheshire	Ely Cambridgeshire
Kodi postar:	SK9 5AF	CB7 4EA
Posta elektronike:	casework@ico.org.uk	compliance@sovaassessment.com

ARKIVI I HISTORIKUT TË NDRYSHIMEVE

Përditësuar rishtazi më 24 maj 2021, V 2.1